



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN160820230007

Tiranë, më: 05.10.2023

Komisioni 105

DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L62423006M

Adresa e selise: Tiranë, Rruga "Sami Frashëri, qendra "Metropol", pallati "Vortek", Nr.14, kati 2, përballë Drejtorisë së Policisë

Personi përgjegjës: Indrit Gashi

Për të zhvilluar projektin: “**Ndërtimi i hidrocentraleve Batër, Frankth, Selitë**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10 440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 9, “Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”, Pika 1. Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen: b) projektet, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të kësaj procedure. Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike;

Vendndodhja: Pellgu i Përroit të Zalli të Batrës, Bashkia Mat, Qarku Dibër

Fuqia e instaluar: 6 338 kW

Numri i HEC-eve: 3 (Batër, Frankth, Selitë)

(Bashkangjitur Aneksi 1 , gjendet gjurma e projektit.)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike në Ministrinë e Mjedisit shprehën: Sugjerohet që gjatë ndërtimit të veprimtarisë, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;

- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;

- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;

- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar;

- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar;

- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;

- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

○ Sektori i mbrojtjes së natyrës sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve:

- Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar;

- Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëhet rehabilitimi i zonës me mbjellje pemësh.

○ Sektori i pyjeve sugjeron të realizohet rehabilitimi menjëherë pasi të mbarojnë punimet në këtë sipërfaqe, sipas projektit që do të zbatohet, në zbatim të ligjit 57/2020 “Për Pyjet” në mënyrë të veçantë neni 12, i tij dhe ligjin nr. 9693 datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”.

Të realizohet rehabilitimi menjëherë pasi të mbarojnë punimet në këto sipërfaqe, sipas projektit që do të zbatohet.

○ Pavarësisht se energjia e prodhuar nga hidrocentralet konsiderohet si energji e pasër, pasi nuk shoqërohet me çlirime gazesh të dëmshëm në atmosferë, përsëri këto HEC-e kanë ndikimin e tyre në mjedis, duke qënë se skenarët e ndryshimeve klimatike parashikojnë çrregullim të rreshjeve në Shqipëri, me pakësimin e tyre gjatë periudhës të verës, dhe uljen e shpeshtësisë, si dhe rritjen e intensitetit të tyre gjatë periudhës së dimrit (sipas raportit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike-IPCC 2021).

Një tjetër ndikim negativ që HEC-et kanë në mjedis ka të bëjë me faktin se ndërtimi i HEC-eve kërkon heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve ku do të ndërtohen, e cila ndikon në reduktimin e sipërfaqeve të gjelbëra, që konsiderohet si një nga depozituesit kryesorë të karbonit në planet. ○ Me

qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti:

Hidrocentrali “Selitë, Frankth, Batër”, me zhvillues dhe aplikues “ELECTRAL BATRA HPP”, me nr. Aplikimi AN040820230004, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër shprehet : Pas shqyrtimit të dosjes së VNM se paraqitur nga zhvilluesi ‘ELECTRAL BATRA HPP’ sh.p.k. për veprimtarinë “Ndertim i Hidrocentraleve Bater, Frankth, Selitë”, me vendodhje në Perroi Batres, Bashkia Mat

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, sugjeron që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal. Gjithashtu, sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

1. Të kihet kujdes në ndërtimin e rrugëve hyrëse për të mos shkaktuar degradimin e karakteristikave të peizazhit natyror.
2. Të shmangët heqja e vegjetacionit natyror, gjurmimi në shpatet e pjerrëta, pasi mund të behen shkak për erozion të pasojë e punimeve.
3. Mbetjeve e ndërtimit, si materialet e gjurmimit të mos depozitohen në brigjet e lumenjve ose në shtratin e lumit.
4. Të mos ketë devijime të rrjedhjes së ujit e cila është një përcaktues kryesor i biodiversitetit, devijimi i saj do të ketë pasoja dhe për biodiversitetin.
5. Të respektohen standardet zyrtare për zhurmat dhe dridhjet, siç parashikohet në Ligjin 9774/2007; “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”; dhe të monitorohen zhurmat dhe dridhjet nga aktivitetet e projektit, siç parashikohet nga Urdhëri i MM 1037/1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore: Aprovim automatik në heshtje

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë: Aprovim automatik në heshtje

Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Në dëgjuesën me publikun të zhvilluar në fshatin Selixë, datë 21.07.2023, ora 10:30, morën pjesë Përfaqësues i bashkisë Mat, Drejtori i Bujqësisë dhe Pyjeve, Administrator i Njësisë Administrative Koms, Krytari i fshatit Selixë, përfaqësues nga komuniteti i zonës, Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Nga ana e investitorëve iu sigurova të pranishmeve që

do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- **Në mendimet e anëtarëve të Komisionit nr. 105, datë 04.10.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**
- **Deklaratën Mjedisore me nr.10827/1 Prot. datë.19.12.2019.**
- Kontratës shtesë të koncensionit Nr. 813 Rep, Nr. 273 Kol, datë: 06.09.2017, lidhur midis Ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë dhe shoqërisë “ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k.. për disa ndryshime në Kontratën e Koncensionit të Formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentrale “Batra Nr. 1, Nr. 2 dhe Batra Nr. 3”, e ndryshuar.

3. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e, nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.

- 3.1** Ky aktivitet të zhvillohet në përputhje të plotë me Kontratën Konçensionare / Miratimin Paraprak, Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, Leje për Shfrytëzimin e ujit, të miratuara nga organet kompetente (KKT / Bashki / Njësi Administrative apo institucioneve të tjera) sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 3.2** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Kreu I, Neni 1, Pika A); Kreu II, Neni 7, Pika 1; Kreu V, Neni 20, Pika 1.
- 3.3** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga Njësia Qeverisjes Vendore
- 3.4** Subjekti ka detyrimin e menaxhimit të mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara të pajisura me Kod Unik
- 3.5** Subjekti të kryejë aktivitetin brenda koordinatave të miratuara nga autoritetet kompetente.
- 3.6** Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor.
- 3.7** Të instalohen të gjithë agregatet e deklaruar në raportin e VNM-së ku përfshihen edhe ato që parandalojnë apo minimizojnë ndikimet në mjedis.
- 3.8** Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të dhëna në relacionin teknik.
- 3.9** Subjekti të respektoj dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 3.10** Të forcohen brigjet e rrjedhës ujore duke mbjellë fidanë të rinj në brigjet e saj paralelisht me ndërtimin e veprës.
- 3.11** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 3.12** Ndërtimi i HEC-it të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellësi kanale etj.

- 3.13** Për asnjë arsye të mos çenohet aktiviteti i përditshëm bujqësor i banorëve përreth, duke minimizuar kështu impaktin social.
- 3.14** Të bëhet kujdes me ruajtjen e ekosistemit ujor, duke mos çenuar në asnjë mënyrë segmentet ujore.
- 3.15** Të respektohen të gjitha kushtet teknike dhe standartet, për operimin e punës brenda subjektit sipas relacionit të përshkruar në VNM.
- 3.16** Niveli i zhurmave gjatë procesit të ndërtimit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët (jo herët në mëngjes dhe jo vonë në mbrëmje).
- 3.17** Të merren masat teknike dhe organizative për zbutjen e ndikimeve në mjedis të gjeneruara nga operacionet e gërmimit dhe gjenerimit të dherave.
- 3.18** Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 3.19** Subjekti të kujdeset për menaxhimi e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, si të ambalazhimit dhe mbetjeve inerte, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore sipas legjislacionit në fuqi.
- 3.20** Të parashikohen dhe merren masa për parandalimin dhe kontrollin e ndotjeve në tokë gjatë fazës së instalimit të pajisjeve teknologjike për ndërtimin e veprave, si derdhje lëndësh ndotëse, vajra lubrifikues, graso, karburante etj.
- 3.21** Të përdoren mjete të kolauduara për ndërtimin dhe zbatimin e projekti, me qëllim evitimin e ndotjeve të mundshme si pasojë e dëmtimit apo avarie të mundshme.
- 3.22** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis emetimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve;
- 3.23** Parkimi i mjeteve dhe ruajtja e makinerive të bëhet vetëm brenda sipërfaqes së kampeve të ndërtimit dhe në vendin e përcaktuar;
- 3.24** Transporti i materialit inert të bëhet me mjete të pastra sidomos nga balta (të pastrohen gommat para daljes në rrugë të asfaltuar), gjatë transportit mjetet transportuese të mbulohen me mbulesa të cilat parandalojnë rrjedhjet e materialit në rrugë dhe emetimin e pluhrave;
- 3.25** Shërbimi i automjeteve, magazinimi ose mbajtja e mjeteve ndihmëse të punës si pjesë këmbimi për automjete, lubrifikante, goma etj. të bëhen në vende të tilla që të evitojnë dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis;
- 3.26** Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren (shpime, cigare etj) dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.27** Të funksionojnë rregullisht të gjithë agregatat teknologjike të mbrojtjes së mjedisit;
- 3.28** Subjekti të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- 3.29** Operacionet e ndërtimit të veprës të shmangin në maksimum dëmtimin e tokës dhe pengojnë zhvillimin e proceseve të degradimit mjedisor, si erozionin etj;
- 3.30** Për parandalimin e rrjedhjes së sterileve në drejtim të rrugës, përrrenjve apo proskave të zonës, të bëhet depozitimi i tyre duke ndërtuar mure gabioni, blloqe gurësh të çrregullt ose instalimi i rrjetave metalike në shpatet e malit, si dhe sistemimi i masave të dheut që dalin nga ndërtimi i veprës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave nga ndotjet e mundshme dhe kompaktësinë e formacioneve gjeologjike të zonës.
- 3.31** Masat e dheut që gjenerohen nga punimet ndërtimore duhet të mbahen nën kontroll dhe të mos lejohen të rrëshqasin dhe sedimentojnë në rrjedhat ujore në zonën e ndërtimit, përfshirë edhe shtratin e ujëmbledhësit (rrisin turbullirën, dëmtojnë gjendjen natyrale të lumit, etj.) dhe të sistemohen në vendepozitime të paracaktuara në bashkëpunim me qeverisjen vendore.

Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte. Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë kantierit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

- 3.32 Në rast aksidentesh ose defektsh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM-në, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.33 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat e Vendimit dhe pasojat e mos-zbatimit të tyre në mjedis dhe në marrëdhëniet e subjektit me organin e dhënies së Vendimit që të evitojnë dhe kontrollojnë ndotjen në mjedis.
- 3.34 Më qëllim mbrojtjen e ekosistemit dhe natyralitetit të përroit në segmentin ku do ndërtohet hidrocentrali shoqëria të lejojë rrjedhjen në shtratin egzistues të lumit dhe burimeve ujore sasinë e ujit të përcaktuar nga organet kompetente.
- 3.35 Të dimensionohen dhe ndërtohen veprat e shuarjes së energjisë së rrymës ujore pas daljes nga kanali me deviacion, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e erozionit ujqor.
- 3.36 Përgjatë gjithë perimetrit dhe sheshit ku kryhet aktiviteti të mbillen kurorë pemësh të larta në mënyre që të reduktohet impakti negativ në pamjen e zonës. Pemët të jenë të llojit të mjedisit ku do mbillen.
- 3.37 Për të ruajtur informacionin mbi zbatimin e kushteve të Vendimit, gjatë fazës së ndërtimit të veprës subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë për monitorimin e cilësisë së tokës, ajrit dhe ujërave, si dhe prurjen e rrjedhës ujore gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve, të cilin duhet ta vëre në dispozicion të institucioneve shtetërore si dhe të interesuarve të tjerë për përmbajtjen e këtij regjistri.
- 3.38 Të pastrohet menjëherë çdo rast ndotje e mjedisit brenda dhe jashtë objektit si pasojë e aktivitetit.
- 3.39 Të bëhet pajisja me tabela informuese dhe drejtuese për shmangien e rreziqeve dhe pasojave me ndikim në mjedis brenda zonës së veprave.
- 3.40 Të hartohet Plani i Përballimit të Emergjencave i plotë dhe i detajuar, para vendosjes në funksionim të veprës dhe të raportohet pranë AKM-së për përmbajtjen e këtij planit.
- 3.41 Të trajnohen të gjithë punonjësit dhe të njihen me termat e Planit të Përballimit të Emergjencave.
- 3.42 Përcaktimi i hedhjes së dherave në vende të zhveshura, të eroduara, gropa, që rezultojnë gjatë punimeve dhe sheshimi e nivelimi i tyre, përgatitur për mbjellje.
- 3.43 Sipërfaqet e eroduara, të zhveshura dhe të shpyllëzuara të mbillen me bimësi barishtore, shkurre dhe pemë pyjore të llojeve autoktone sepse krahas zënies së lartë që kanë, shërbejnë si ushqim e strehim për faunen.
- 3.44 Të kryhen punime hidroteknike për të minimizuar fenomenin e erozionit si prita me mure guri të thatë, gardhe dhe mbjellje me pemë pyjore.
- 3.45 Gjatë periudhës së ndërtimit të HEC-ve, të përdoren mjete e makineri që plotesojnë standardet e BE-s.
- 3.46 Të evitohet turbullimi i ujit që ndikon drejtëpërdrejtë në ciklet biologjike.
- 3.47 Për të ulur ndikim negativ të peisazhit nga ndërtimi i HEC-ve, të kryhen mbjellje të pemëve me kurora të gjera dhe të larta.
- 3.48 Të lihet pjesë e rrjedhjes së lirë të ujit për të siguruar vazhdimësinë e faunës ujore.
- 3.49 Të ruhet Q_{ek} sipas kërkesave në Nenin 39, të Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, gjatë fazës së funksionimit.
- 3.50 Në përfundim të aktivitetit ndërtimor të hidrocentralit të rehabilitohet sipërfaqja e ndikuar nga ndërtimi i tij (rrugë, sheshe për depozitim materiale, kanali i derivacionit).

- 3.51 Para fillimit të operacioneve të ndërtimit të hartohet plani rehabilitimit mjedisor i plotë dhe i detajuar i rehabilitimit të bimësisë dhe territorit ku do të kryen punimet për realizimin e projektit.
- 3.52 Në rast se gjatë fazës së instalimit, projekti ka nevojë për vepra të tjera në shërbim të tij (venddepozitime, rrugë etj.), subjekti duhet t'i nënshtrohet procedurave të VNM-së sipas legjislacionit në fuqi.
- 3.53 Të sistemohet sipërfaqja e shesheve të veprave dhe brigjeve të përroit dhe të bëhet mbjellja e pemëve dhe bimësisë autoktone.
- 3.54 Brenda tre muajve nga data e marrjes së Deklaratë Mjedisore, subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së, për miratim, planin e rehabilitimit.
- 3.55 Duhet të raportojë çdo 6 muaj pranë AKM-së për ecurinë e punimeve të rehabilitimit mjedisor.
- 3.56 Plani i rehabilitimit mjedisor përfshin zonat ku do të realizohen punime rehabilituese, volumin dhe llojin e punimeve, përfshi dhe afatet kohore të realizimit të punimeve të rehabilitimit.
- 3.57 Detyrime të monitorimit dhe raportimit mjedisor gjatë fazes së ndërtimit të veprës:
- 3.58 Monitorimi është procesi i vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave në mënyrë periodike ose të vazhdueshme mbi fenomenet natyrore që zhvillohen në objekt, si pasojë e ndërtimit të veprës.
- 3.59 Vetmonitorimi i veprimtarisë realizohet në bazë të programit individual të monitorimit i cili duhet të trajtojë çështjet e mëposhtme:
- 3.60 Monitorimi i ndotjes akustike si pasojë e punimeve të ndërtimit të veprës
- 3.61 Monitorimi i ndikimeve të veprimtarisë në mjedisin përreth dhe elementë të tij
- 3.62 Monitorimi i mënyrës së zbatimit të kushteve të Deklaratës
- 3.63 Monitorimi i ecurisë së realizimit të masave të rehabilitimit dhe efektivitetit të tyre.
- 3.64 Monitorimi i rrjedhës natyrore të burimit ujor që përdor hidrocentrali, prurjen ekologjike, si edhe zhvillimin e gjendjen e biodiversitetit.

Sanksionet e mundshme:

- 3.65 Për mos respektimin e kushteve të Vendimit dhe të legjislacionit mjedisor ka sanksione ligjore
- 3.66 Ndëshkimi administrativ dhe penal i subjektit që nuk zbaton kushtet e Vendimit
- 3.67 Pezullimi i aktivitetit për një afat kohorë.

Raportimi i të dhënave mjedisore:

- 3.68 Në zbatim të kërkesave ligjore subjekti duhet të bëjë vlerësimin mjedisor periodik të veprës gjatë fazës së instalimit;
- 3.69 Për të mbajtur informacionin mbi monitorimin, zbatimin e kushteve, subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë.
- 3.70 Të dhënat e vetëmonitorimit dhe të zbatimit të kushteve të Vendimit duhet ta vërë në dispozicion të institucioneve shtetërore, si dhe të interesuarve të tjerë.
- 3.71 Për çdo ndryshim të planifikuar në teknologji, operacione të paparashikuara dhe deklaruara në raportin e paraprak të VNM-së, të njoftohet menjëherë DRM-në e qarkut përkatës.
- 3.72 Të njoftohet DRM-ja e qarkut përkatës, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.
- 3.73 Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Vendimit, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-se një relacion shkresorë në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).
- 3.74 Bazuar në ligjin Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar, subjekti të hartojë dhe një plan masash për ruajtjen e florës dhe faunës, duke ndaluar dëmtimin ose shkatërrimin e zonave të shumimit ose të vendeve të qëndrimit, për këto specie.
- 3.75 Në përfundim të punimeve subjekti të dorëzojë pranë AKM-së, një relacion ku të pasqyrohen edhe me foto, gjëndja e mjedisit dhe të gjitha punimet rehabilituese të territorit përreth.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	07.04.2024	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	07.04.2024	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	07.04.2024	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	07.04.2024	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	07.04.2024	Çdo 6 muaj

Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodicite ti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	07.04.2024	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
 - Vendimi për VNM-në paraprahe për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
 - Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprahe, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI


MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI


Konceptoi:

Pranoi:


Aneksi 1. Planvendosja dhe koordinatat



Plan-vendosja e përgjithshme e veprave të HEC Batare
rrugët ekzistuese dhe rrugët e reja që do të hapen për ndërtimin e hec-it



Plan-vendosja e përgjithëshme e veprave të HEC Frankth
 rrugët ekzistuese dhe rrugët e reja që do të hapen për ndërtimin e hec-it



Gradina e kontrollit e HEC SGLU TG
 Kulla e nivelit të lartësia pëllon 444.00 m
 Kulla e shkallimit 442.10 m
 X=4411919.014, Y=4802297.435

Vija e marrjes+Delanlari e HEC Frankth
 Kulla e nivelit normal 44.000 m
 X=4412030.420, Y=4802297.435

Kanali i derivatezimit HEC Frankth, Shtet me
 Shtet 20.00 m, L=2350 m, pjerresha 1:1.5%

Rruga e re që do të hapet për trasenë e kanalit
 të derivatezimit dhe rrethorimit do të shërbejë
 për lidhjen e vija të HEC Frankth

Tubacioni i lartësia HEC Frankth,
 Culla me D=1.0 m, L=810 m

Gradina e kontrollit e HEC Frankth
 Kulla e nivelit normal 304.00 m
 Kulla e shkallimit 304.00 m
 X=4414014.313, Y=4802300.225

Vija e marrjes+Delanlari e HEC Frankth
 Kulla e nivelit normal 30.000 m
 X=4414020.540, Y=4802302.241

Shtet i presorit HEC Frankth
 Kulla e nivelit normal 435.00 m
 X=4413918.881, Y=4802347.433

Rruga ekzistuese e Frankth

10 m. Stragjul